



**Kolegji ESLG**

# Kodi i Mirësjelljes i Stafit Akademik

## Hyrje

Kodi i Mirësjelljes është miratuar nga ESLG si një deklaratë e parimeve dhe udhëzimeve etike të cilat janë me rëndësi për institucionin në përgjithësi dhe stafin akademik.

## Qëllimi

Qëllimi i këtij Kodi të Mirësjelljes është të ndihmojë stafin akademik të punësuar në universitet të identifikojë dhe zgjidh çështjet etike të cilat mund të lindin gjatë punës së stafit akademik.

## Neni 1

### Liria dhe përgjegjësia akademike

- 1.1 Stafi akademik është përgjegjës për avansimin dhe shpërndarjen e njohurisë tek studentët dhe më gjerë.
- 1.2 Stafi akademik është përgjegjës për sigurimin e ekselencës në hulumtim dhe mësimdhënie.
- 1.3 Liria akademike është me rëndësi thelbësore për mësimdhënien dhe hulumtimin.
- 1.4 Stafi akademik duhet të angazhohet në mësimdhënie, studim dhe hulumtim në ato fusha ku ata kanë më së shumti ekspertizë.
- 1.5 Roli i stafit akademik është që të sigurojë barazi duke afirmuar mundësi të barabarta arsimore dhe të punësimit.

## Neni 2

### Stafi akademik si mësimdhënës dhe mbikëqyrës i studentëve

- 2.1 Stafi akademik duhet të trajtojë studentët me respekt gjatë gjithë kohës.
- 2.2 Stafi akademik nuk duhet të lejojë raporte personale me studentë të cilat do të ndikojnë në raportin profesional ndërmjet tyre.



## Kolegji ESLG

- 2.3 Stafi akademik duhet të njeh se të gjitha llojet e keqtrajtimit të studentëve janë plotësisht të papranueshme.
- 2.4 Stafi akademik duhet të inkurajojë studentët të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të shkëmbejnë ide lirisht;
- 2.5 Stafi akademik duhet të zhvillojë dhe ruajë ekspertizën në fushat në të cilën ata japin mësim.
- 2.6 Stafi akademik duhet të komunikojë në mënyrë efektive në kontekst të mësimdhënies formale dhe joformale dhe t'u lejojë studentëve një qasje të arsyeshme tek ta;
- 2.7 Stafi akademik duhet të zhvillojë procedura të vlerësimit të cilat janë fer dhe efektive dhe që kontribuojnë në mësimin e studentëve dhe të administrojnë vlerësimin e suksesit të tyre në mënyrë fer dhe efikase dhe duhet të ofrojnë rekomandimet e tyre për përmirësimin e studentëve me kohë dhe në mënyrë konstruktive;
- 2.8 Stafi akademik duhet të sigurojë që ata të kenë dijeni për rregulloret e kolegjit të cilat kanë të bëjnë me mësimdhënien e tyre dhe procedurat e vlerësimit;
- 2.9 Stafi akademik duhet vazhdimisht të kërkojë përmirësimin e efektshmërisë së mësimdhënies në bazë të të gjitha informatave në dispozicion për performansën e tyre dhe ndikimin e tyre tek studentët;
- 2.10 Stafi akademik duhet të zhvillojë aktivitete profesionale dhe zhvillimore të cilat kanë për qëllim përmirësimin e efektshmërisë së mësimdhënies;
- 2.11 Sipas nevojës, stafi akademik duhet të ofrojë këshilla dhe ndihmë për ish studentët gjatë zhvillimit të tyre akademik dhe profesional;
- 2.12 Stafi akademik duhet të përmbahet nga zbulimi i informatave konfidenciale që kanë të bëjnë me studentët pa lejen e studentit përpos në rastet kur një gjë e tillë është e lejuar me ligj.
- 2.13 Stafi akademik duhet të mbajë ligjërata në lëndët që i jep brenda orarit kohor të përcaktuar dhe në mënyrë të hollësishme.



## Kolegji ESLG

2.14. Staf i akademik është i obliguar që të zhvillojë mësimdhënien dhe hulumtimin me standard të lartë.

2.15 Staf i akademik është i obliguar që të mos favorizojë ndonjë studentë duke i'a treguar provimin apo duke i'a dhuruar notën e pamerituar dhe në këtë mënyrë duke vepruar në mospajtim të plotë me statusin e tij si ekzaminues i kolegjit.

2.16 Staf i akademik është i obliguar që të mos përfshihet në plagjiarizëm të punës së autorëve tjerë.

### Neni 3

#### Stafi akademik si hulumtues dhe studiues

3.1 Staf i akademik duhet të trajtojë hulumtuesit dhe studiuesit tjerë me respekt gjatë gjithë kohës.

3.2 Staf i akademik duhet të zhvillojë forma të reja të rritjes së ekspertizës së tyre si për të mirën e tyre personale por edhe për interesin e përgjithshëm publik

3.3 Staf i akademik duhet të njoh në mënyrë rigoroz kontributin e bërë nga të tjerët gjatë hulumtimit dhe studimit të tyre sidomos duhet të njoh kontributin e kolegëve dhe studentëve;

3.4 Staf i akademik duhet të pranojë obligimin për të shpërndarë rezultatet e hulumtimit të tyre nëpërmjet të publikimit, prezentimit në konferenca dhe mënyra të tjera;

3.5 Staf i akademik duhet t'i respektojë standardet e etikës profesionale si ato në nivel nacional gjithashtu edhe ato të pranuar ndërkombëtarisht.



## Kolegji ESLG

### Neni 4

#### Stafi Akademik si konsulente të jashtëm

- 4.1 Stafi akademik duhet në asnjë mënyrë të merret me punë të cilat ndërhyjnë në kryerjen e detyrave të tyre si të punësuar të kolegjit;
- 4.2 Stafi akademik nuk duhet të angazhohet në asnjë punë e cila do të komprometonte integritetin dhe pavarësinë e tyre si staf akademik;
- 4.3 Stafi akademik duhet të përfaqësojë kompetencën e vet akademike në mënyrë të besueshme;
- 4.4 Stafi akademik nuk duhet të përfaqësojë vetën se është duke vepruar në emër të kolegjit gjatë zhvillimit të punës private të konsulencës;

### Neni 5

#### Stafi akademik në raport me stafin tjetër

- 5.1 Stafi akademik duhet të respektojë stafin tjetër të kolegjit gjatë gjithë kohës;
- 5.2 Stafi akademik duhet të ndihmojë kolegët sipas nevojës dhe të veprojë si mentor për kolegët e rinjë;
- 5.3 Stafi akademik nuk duhet të dëmtojë reputacionin dhe shansat e karrierës së stafit tjetër;
- 5.4 Stafi akademik nuk duhet të lejojë që raportet personale me stafin tjetër të mos ndikojnë në raportet profesionale ndërmjet tyre.



## Neni 6

### Stafi akademik si i punësuar i kolegjit

- 6.1 Stafi akademik duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave të kolegjit.
- 6.2 Stafi duhet të merr pjesë në mënyrë të duhur në jetën institucionale të kolegjit;
- 6.3 Stafi duhet të përmbahet nga përfaqësimi i kolegjit si zëdhënës përpos nëse janë të autorizuar t'a bëjnë një gjë të tillë;
- 6.4 Stafi duhet të mbështes reputacionin e kolegjit dhe të mos angazhohet në aktivitete të cilat do të dëmtonin reputacionin e tij.

## Neni 7

### Përgjegjësia disiplinore


- 7.1 Në rast të dështimit të stafit akademik për t'ju përmbajtur dispozitave të kodit të mirësjelljes, kundër tij/saj do të ndërmerren hapa disiplinor nga ana e Komisionit për Disiplinë të emëruar nga Senati i Kolegjit me pëlqimin paraprak të Bordit të Kolegjit.

## Neni 8

### Hyrja në fuqi

- 8.1 Ky kod hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Presidenti i Bordit Menaxhues.

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, 20.08.2019



Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës  
T: +383 38 602 405  
T: +383 44 159 867  
E: [info@eukos.org](mailto:info@eukos.org)  
W: [www.eukos.org](http://www.eukos.org)

